

**RAPORTI**

**I MONITORIMIT**

**TË**

**MATURËS**

**SHTETËRORE**

**2022**



Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministristvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

**KYC** | KOSOVAR  
YOUTH COUNCIL



KYC  
Rr. Kroi i Bardhë, nr.81, Dardani  
Prishtinë 10000, Kosovë  
kyckosova@gmail.com  
+383 (44) 96 45 75

**Autor:** Blendi Sheremeti  
**Dizajni:** Ditjon Fetahu  
**Grumbullimin e të dhënave në terren:**  
Grupi i Monitoruesve të Rinjë (YMG)

---

---

---

Të drejtat e autorit © 2022. Këshilli Rinor Kosovar (KYC).

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Ky dokument është pronë e KYC, andaj çdo kopjim, përdorim i plotë apo i pjesshëm i materialit pa cituar burimin apo pa lejen paraprake të KYC ndalohet.

# HYRJE

Këshilli Rinor Kosovar (KYC) është organizatë jo-qeveritare e cila aktivitetin e vet për ndërtimin e qëndrueshmërisë shoqërore e shtrin përmes promovimit të aktivizmit rinor, mbështetjes së të rinjëve, angazhimit të të rinjëve në procese vendimmarrëse, fuqizimit të kapaciteteve të tyre, përfaqësimit të zërit rinor, promovimit të edukimit të vetë-organizuar dhe mbështetjen e zhvillimit të politikave rinore. Të rinjtë, pra, janë motori i organizatës me të cilët ne synojmë të rrisim cilësinë në arsim. KYC aktivitetin e tij e shtrin përmes tri programeve kryesore: programit të edukimit, programt të zhvillimit rinor dhe aktivizmit rinor; me të cilët orientohet puna drejt arritjes së qëllimeve dhe vlerave fundamentale të KYC-it. Procesi i monitorimit të Maturës Shtetërore hyn në kuadër të programit të edukimit dhe aktivizmit rinor i cili përveq ndikimit në cilësinë e përgjithshme të arsimit synon përfshirjen e vet rinisë në procese vendimmarrëse, evidentuese, organizative dhe administrative.

Provimi i Maturës Shtetërore është proces i mbledhjes, përpunimit, analizimit, vlerësimit dhe i interpretimit të dhënave me qëllim të përcaktimit të shkallës së njohurive dhe zotërimit të kompetencave për nxënës të përcaktuara me kurrikulë, saktësisht i përcaktuar kështu sipas LICJI. Nr. 05/L - 018 për Provimin e Maturës Shtetërore. Rrjedhimisht, është përcaktues i shkallës së njohurive të arritura përgjatë mësim-nxënies në institucion arsimor dhe aftësues që realizon shërbime arsimore të nivelit 3 sipas Standardeve Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit - ISCED, apo ndryshe niveli i Arsimit Para-Universitar. Duke pasur parasysh rëndësinë e tij vlerësuese,

KYC si organizatë jo-qeveritare kontribuon prej 10 vitesh periudhë kohore, vazhdimisht në monitorimin e mbarëvajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore, duke ofruar kështu përmbledhje krahasuese të çështjeve teknike, administrative dhe rekomandime për përmirësim të cilësisë së mbarëvajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore. Ky proces përveq ndikimit që e ka në promovimin e punës efektive të administruesve, vetëdijësimin e nxënësve për respektimin e rregullave të testimit ka për qëllim edhe mbajtjen e një databaze e cila pasqyron progresin e administrimit të këtij procesi përgjatë viteve e cila shërben si një pike referuese për KYC-in, institucionet arsimore dhe çdo palë tjetër të interesit.

KYC në bashkëpunim me hisedarët përgjegjës institucional të organizimit të këtij provimi synon të pasqyrojë përmbushjen e dispozitave ligjore, mbajtjen e provimit, të drejtave të kandidatit/es, procedurave teknike dhe administrative të Provimit të Maturës Shtetërore, përmbajtjes së Provimit të Maturës Shtetërore, ndjekjen e kriterëve dhe rregullave të përcaktuara nga Divizioni për Vlerësim, Standarde dhe Monitorim (DVSM), detyrave dhe përgjegjësi të Komisionit në qendrat e testimit, administrueseve/ëve dhe mbikëqyrësve/ëve.

Monitorimi i Provimit të Maturës Shtetërore, është pjesë e planit të veprimit dhe planit strategjik të KYC në kuadër të Programit të Edukimit që ndër të tjera synon: “Arritjet e nxënësve dhe arsimimi cilësor janë thelbësore për suksesin afatgjatë të zhvillimit, të mundësimin të një jete të shëndetshme dhe kualitative, dhe të punësimit të rinjve/rejave. Përmes punës në edukim dhe në procese të avokimit dhe politikë-bërjes, KYC aspiron të ngrisë zërin e të rinjve/rejave dhe të ndikojë në rolin vendim-marrës në formësimin e politikave arsimore”.

Prandaj, Monitorimi i Provimit të Maturës Shtetërore është komponentë shumë e rëndësishme për rritjen e cilësisë së arsimit si një mjet që matë dijen e dhënë, pra përtej si proces procedural e administrativ, rezultatet dhe mbarëvajtja e tij japin si informatë dhe perspektivën, dhe nivelin e cilësisë së sistemit arsimor përgjithësisht.

# RËNDËSIA E MONITORIMIT

Provimi i Maturës Shtetërore është proces i rregulluar me bazë ligjore në Ligjin për Provimin e Maturës Shtetërore, dhe akteve të tjera nënligjore. Kësisoj, duke konsideruar rëndësinë shtetërore të tij krahas vlerësimit të mësim-nxënies dhe mësim-dhënies bazuar në Kurrikulë, KYC për vite të tëra bëhet aleat i procesit të monitorimit në terren duke përfshirë një numër të madh të qendrave të testimit. Përkundër bazës ligjore ku përcaktohet saktësisht rëndësia, roli i secilit hisedarë, dhe mbarëvajtja, Provimi i Maturës Shtetërore vit pas viti pëson ndryshime, procedurale dhe administrative. Pavarësisht ndryshimeve të këtij lloji, elementet përmbajtjesore të procesit të Provimit të Maturës Shtetërore të vitit 2022 ishin:

- Afati i parë i Maturës Shtetërore u mbajt më 18 Qershor 2022, në të njëjtën kohë për të gjithë kandidatët/et;
- Afati i dytë i Maturës Shtetërore u mbajt më 27 Gusht 2022, në të njëjtën kohë për të gjithë kandidatët/et;
- Provimi i Maturës Shtetërore mbahet brenda një dite për të gjitha lëndët dhe të gjithë/a kandidatët/et;
- Pragu i kalueshmërisë: 40 % e totalit të pikëve të mundshme;
- Testi ka 100 kërkesa (pyetje, detyra), 25 kërkesa për lëndë;
- Testi zgjatë 150 minuta;
- Lëndët e përfshira: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze dhe Matematikë si lëndë bazë dhe një lëndë zgjedhore që përzgjidhet nga vet kandidati/ja.

“Monitoruesit mund të autorizohen nga Komisioni Shtetëror i Maturës (KSHM) për të monitoruar procesin e testimit qoftë për raportime tek mediat, organizatat joqeveritare dhe për qëllime të rritjes së presionit ndaj procesit të administrimit për të rritur nivelin e disiplinës”. Në këtë rast, KYC ka parashtruar kërkesën për monitorim dhe është autorizuar nga KSHM për monitorim të Provimit të Maturës Shtetërore. KYC i ka pasur të përcaktuar formularët e raportimit të monitoruesit të Provimit të Maturës Shtetërore dhe zberthimi i këtyre formularëve në formë përmbledhëse do të paraqitet më poshtë.

Në këtë rast, rëndësia e monitorimit shtrihet vlerëshmërisht në rëndësinë e mbarëvajtjes së procesit, për të lehtësuar kështu identifikimin e problemeve të shfaqura gjatë testimit, sfidave dhe parregullsive që ulin cilësinë e testimit, dhe për të krijuar rekomandime që do të kishin plotësuar dhe përmirësuar procesin e Provimit të Maturës Shtetërore në vitet e ardhshme.

# METODOLOGJIA

Monitorimi i Maturës Shtetërore është organizuar plotësisht nga KYC-i me autorizim nga DVSM dhe miratim nga KSHM. KYC-i ka angazhuar 107 monitorues në afatin e parë të testimit kurse 40 monitorues në afatin e dytë duke konsideruar numrin e qendrave në çdo komunë. Procesi i monitorimit ka kaluar nëpër disa faza të cilat kanë paraprirë ditën e Maturës Shtetërore në mënyrë që të realizohet qëllimi ynë sa më suksesshëm. Mirëpo para se të ceken fazat nëpër të cilat kalon ky proces është me rëndësi të ceken raportet e strukturuar nga KYC dhe rëndësia e tyre në procesin e evidentimit të shkeljeve gjatë testimit.

## Raportimet në kohë reale:

Raportimet në kohë reale janë forma të shkurtëra të raportimit, të krijuara prej KYC, qëllimi i të cilave është raportimi direkt i problemit përmes të cilit na ipet mundësia të reagojmë direkt në atë moment. Këto raporte janë krijuar në nivel rajoni, ku është bërë ndarja e tyre në formularin për Rajonin e Prishtinës (Prishtinë, Besianë, Fushë Kosovë, Drenas, Kastriot), Rajonin e Prizrenit (Prizren, Therandë, Sharr), Rajonin e Ferizajit (Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Shtërpçë, Lipjan, Han i Elezit), Rajonin e Mitrovicës (Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj), Rajonin e Gjilanit (Gjilan, Viti, Kamenicë, Artanë), Rajonin e Cjakovës (Cjakovë, Malishevë, Rahovec) dhe Rajonin e Pejës (Pejë, Klinë, Burim, Deçan, Junik) në mënyrë që të bëhet filtrimi dhe reagimi më i shpejtë ndaj çështjes së raportuar.

Monitoruesit janë udhëzuar për përdorimin e kësaj forme në këtë mënyrë:

*“Përmes kësaj forme, ju duhet të raportoni problemet aktuale që mund ti vëreni në qendrën tuaj të testimit. Përmes raportimeve të juaja në këtë formë, ne së bashku me MASHTI do të jemi në gjendje që të ndikojmë menjëher duke e informuar kryetarin/en e qendrës, dhe duke ju kërkuar që të ndikojnë. Këtu mund të bashkangjiti foto dhe video, të problemeve që evidentoni. Vetëm se luteni të shmangni fytyrat e nxënësve. Këtu është e rëndësishme të specifikohet shkolla (numri i qendrës së testimit), klasa ku po ndodh problemi që po raportohet si dhe emrin tuaj”.*

Këto forma janë shumë të rëndësishme pasi që përveq neve i jep edhe MASHTI-it një pasqyrë të gjendjes momentale të menagjimit të testit.

(\*Tabela e bashkangjitur në fund të raportit)

## **Raportimet Përfundimtare:**

Raportimet Përfundimtare janë forma më të gjata të evidentimit të krijuara nga MASHTI, e të cilat plotësohen dhe dërgohen në përfundim të Maturës Shtetërore ku monitoruesit në mënyrë të detajizuar paraqesin ecurinë e tërë procesit prej momentit të hyrjes së tyre në qendër deri tek momenti i fundit i daljes së të gjithë nxënësve nga qendra e testimit.

Monitoruesit janë udhëzuar për përdorimin e kësaj forme në këtë mënyrë:

*“Në përfundim të testimit, ju kërkohet që të plotësoni edhe formën e raportimit final; e cila jep një reflektim të gjithë ditës, që ju keni monitoruar. Ju lutem që ti dërgoni raportimet finale, menjëher pas përfundimit të testimit, mundësisht ti dërgoni më se largu deri në ora 15:00”.*

Më poshtë janë të ndara dhe të elaboruara individualisht fazat prej zgjedhjes së monitoruesve e deri tek raportimi i të dalurave tek MASHTI.

### **A) Përzgjedhja e monitoruesve**

Si procedurë e parë e këtij procesi ka qenë përzgjedhja e monitoruesve përmes thirrjes së hapur të publikuar në faqet zyrtare të KYC-it. Thirrja e hapur ka paraqitur kriteret e nevojshme për monitorim ku ka qenë esenciale mosha mbi 18 vjeçare dhe persona që e kanë përfunduar shkollën e mesme në mënyrë që të evitohen mundësitë e konflikteve të interesit. Poashtu përveq thirrjes së hapur KYC-i ka kontaktuar edhe monitoruesit e viteve të kaluara të Maturës Shtetërore duke konsideruar ekperiencën e tyre paraprake e cila ishte vlerë e shtuar. Përzgjedhja është bërë nga komisioni vlerësues brenda KYC-it duke e bërë koordinimin e të përzgjedhurve në qendrat e testimit të dërguara nga MASHTI. Të përzgjedhurit janë njoftuar me detyrat e tyre paraprakisht si: përmbajtja e rregullores së lëshuar nga MASHTI për monitoruesit përgjatë Maturës, evitimi i pengimit të procesit të testimit, koha e paraqitjes në qendër së bashku me bexhat e çertifikuar nga MASHTI, ndjekja e trajnimit të mbajtur anëtarët e stafit të KYC, raportimi live dhe final në ditën e testimit etj; të cilat janë elaboruar më detajisht në fazën e trajnimit të tyre.

Përcaktimi i monitoruesve nëpër qendra të monitorimit ka qenë në mënyrë rastësore.



## **B) Trajnimi i monitoruesve**

Monitoruesit para monitorimit iu janë parashtruar trajnimit për monitorim në përputhje me Udhëzuesin për Maturën Shtetërore për këtë çështje. Trajnimi është mbajtur nga dy anëtarë të stafit të KYC-it dhe ka qenë i obligueshëm për të gjithë monitoruesit e përzgjedhur për të vazhduar me procesin e monitorimit. Monitoruesve i janë bërë të njohura rregullat si: arritja në qendër të testimit rreth një orë më herët para fillimit të testimit, mënyra e funksionimit të raporteve të strukturuar nga KYC-i, dokumentet e nevojshme (kartën e identifikimit dhe bexhin e çertifikuar), rregullat që duhet ti ndjeknin dhe çështjet që duheshin ti ndjeknin për evidentim (shkeljet nga ana e nxënësve, shkeljet nga ana e administruesve, problemet logjistike nga ana e stafit të shkollës etj) dhe adresimin e çdo paqartësie apo vështirësie eventuale nga ana e monitoruesve.

## **C) Krijimi i rrjetit kontaktues me monitoruesit**

Për të siguruar kontaktin e drejtpërdrejtë me monitorues përveq raportit LIVE, monitoruesit janë rrjetëzuar në një grup të përbashkët online ku kanë përditësuar gjendjen e qendrës së testimit vazhdimisht. Ata poashtu kanë pasur të dhënat e stafit të KYC të cilët kanë pasur mundësinë ti kontaktojnë privatësisht gjatë tërë kohës së testimit për çdo çështje apo vështirësi që iu ka dalur përpara. Pastaj stafi i KYC me të dhënat që i dispononte dhe kontaktin e drejtpërdrejtë me pëfaqësues të MASHTI ka pasur mundësinë të jap informatën e dorës së parë aty për aty.

## **D) Pajisja e monitoruesve me dokumente identifikimi**

Në mënyrë që monitoruesit të mos hasnin rezistencë apo probleme për qasje në qendër të monitorimit KYC i ka pajisur me bexha identifikues të çertifikuar nga MASHTI për të konfirmuar punën e tyre tek zyrtarët e qendrave të testimit.

## **E) Monitorimi dhe raportimi**

Përgjatë testimit monitoruesit nuk kanë pasur të drejtë të hyjnë brenda në klasa, mirëpo kanë bërë vëzhgimin nga korridori i shkollës ku çdo klasë ka qenë e qasshme për vrojtje, në të kundërtën është raportuar rasti në formën LIVE. Monitoruesit kanë evidentuar shkeljet qoftë nga ana e nxënësve apo e administruesve të cilat raporte kanë ardhur direkt tek stafi i KYC, të cilët kanë qenë në një prej hapësirave të MASHTI-it duke i trajtuar rastet një nga një.

## **F) Trajtimi i rasteve nga KYC**

Ditën e testimit, grupi prej 15 anëtarëve i krijuar nga monitorues të KYC dhe anëtar të MASHTI, gjenden në zyret e MASHTI, për të reaguar mbi raportimet në kohë reale. Me kontaktet e siguruara nga MASHTI anëtarët e KYC kanë kontaktuar drejtpërdrejtë kryetarët e qendrave të testimit ku u është kumtuar problemi i raportuar dhe është udhëzuar trajtimi sa më i shpejtë i tij. Në rastet e shkeljeve nga ndonjë nxënës, iu janë dhënë të dhënat e klasës, llojin e problemit dhe rreshtin ku është ulur nxënësi. Pastaj i kemi kontaktuar prap për të konfirmuar masën e marrur ndaj nxënësit. E njejta procedurë është bërë edhe me administruesit për të cilët janë pranuar raporte. Masat që merren zakonisht kanë të bëjnë me: largimin e nxënësit/es nga testimi, largimi i administruesit/es dhe zëvendësimi i administruesit/es. Reagimi ndaj rasteve të evidentuara është i detyrueshëm konform legjislacionit në fuqi për mbarëvajtjen e procesit të testimit.

## **G) Raportet përmbledhëse**

Pas dërgimit të raporteve finale në përfundim të testimit, është bërë përmbledhja e të dhënave dhe të dalurave kryesore të cilat janë dërguar tek përfaqësuesit e MASHTI-it si pasqyrë përmbledhëse e punës së kryer dhe hapësirat më problematike gjatë mbajtjes dhe administrimit të Maturës Shtetërore.



**AFATI I PARË**

# TË GJETURAT KRYESORE

- Nga 107 qendra të monitoruara, 6.6% e tyre nuk ishin të përgaditura siq duhet për testim.
- Rekomandimi i nxënësve nga drejtori/esha për largimin e telefonave dhe mjeteve të tjera elektronike është bërë në mbi 99% të qendrave të testimit të monitoruara nga KYC.
- Nga 107 qendra të monitoruara, në 21.5% është vërejtur prania e shkeljeve të llojeve të ndryshme.
- Nga 107 qendra të monitoruara, në gati 40% të qendrave të monitoruara ka pasur largime të nxënësve dhe administruesve nga testimi.
- Nga 107 qendra të monitoruara, në 11.2% të qendrave të monitoruara ka pasur raste të hyrjes së nxënësve pas fillimit të testit të cilat kryesisht kanë qenë prezente në qendrat e papregaditura për testim.

# KOHA E ARRITJES NË QENDRËN E TESTIMIT DHE PËRGADITJA E TYRE

Arritja e monitoruesve në qendër të testimit është bërë në pajtueshmëri me aktet nënligjore në fuqi dhe Udhëzuesin për Maturën Shtetërore 2022 të cilat kanë përcaktuar si detyrë dhe përgjegjësi që monitoruesit/et të paraqiten në qendrat e testimit një orë (60 minuta) para fillimit të procesit. Rrjedhimisht, monitoruesit/et në terren kanë deklaruar se kanë qenë në kohë në qendrat e testimit dhe nuk është raportuar ndonjë rast shkeljeje në këtë aspekt. Monitoruesit tanë në ditën e testimit janë paraqitur një deri në dy orë më herët në mënyrë që të jenë prezent që nga momenti fillestar i ardhjes së nxënësve në qendër dhe observimi i gjendjes së tyre para testimit.

Shkolla e Mesme e Lartë ka për detyrë dhe përgjegjësi të;

- a) përgatit hapësirën për mbajtjen e provimit të matures shtetërore sipas udhëzimeve nga KSHM/DVSM;
- b) në hyrje të shkollës në vendin e shpalljeve ose në një vend të dukshëm të shënojë listen finale të nxënësve;
- c) në portën e çdo klase të shkruhet lista e nxënësve që do të testohen;
- d) të sigurojë kushtet e organizimit të testit të maturës, më saktësisht "duhet të merrë parasysh numrin e klasave që nevojiten për sigurimin e kushteve të njëjta në secilën klasë duke përfshirë dhe dritën dhe ajrosjen e klasës etj".

Duke konsideruar këto të dhëna nga 107 qendra të monitoruara, 6.6% e tyre nuk ishin të pregaditura siq duhet për testim. Këto raste kishin të bënin me: vonesat e administruesve, mungesa të testeve, probleme me listat e nxënësve, vonesa të drejtorëve etj. Këto të dalura bazohen në raportet finale të dërguara nga monitoruesit, kurse është me rëndësi të cekën të dalurat e detajuara të raportimeve live sipas të cilave në Rajonin e Prishtinës në 10.8% të raportimeve ka pasur mungesë të testeve në qendra të testimit, në Rajonin e Pejës 27.6% mungesë të testeve, në Rajonin e Gjakovës 18.2%. Përndryshe në Rajonin e Prizrenit, Mitrovicës, Gjilanit dhe Ferizajit nuk kemi pasur asnjë raportim për një problem të tillë.

## QENDRA ISHTE E PREGADITUR SIQ DUHET PËR TESTIM

93.4%

## MUNGESA E TESTEVE

PRISHTINË		10.8%
PEJË		27.6%
GJAKOVË		18.2%

# HYRJA E NXËNËSVE DHE MASAT PARAPRAKE

Sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore 2022 dhe Udhëzuesit dhe Rregullave për Kandidatët/et orari i përcaktuar për ditën e testimit është si vijon: Nga ora 8:30 deri në ora 9:00 bëhet arritja e kandidatëve/eve në oborret e qendrave të testimit dhe nga ora 9:00 deri në ora 9:30 bëhet hyrja e kandidatëve/eve në qendra të testimit dhe sistemimi i tyre në klasat e përcaktuara. Ndër të tjera, sipas UA për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit, UA për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administruesit dhe Mbikëqyrësit - si detyra dhe përgjegjësi në vartësi janë dhe:

- Kontrollimi i hapësirës ku mbahet testimi paraprakisht;
- Mirëpritja e kandidatëve/eve dhe sistemimi i tyre;
- Përkujdesja që të gjithë kandidatët/et janë të pranishëm/e pesëmbëdhjetë (15) minuta para fillimit të testimit;
- Pranimi dhe Kontrollimi i Materialeve;


Në bazë të raportimeve të marra, në rreth 40% të qendrave të monitoruara kandidatët/et kanë hyrë në qendër në intervalin e përcaktuar prej orës 09:00 deri në orën 09:30. Pjesa tjetër e kandidatëve janë futur në periudha të ndryshme mes intervalit 9:30 deri në 10:00, pra më vonë se përcaktimi i orës së hyrjes nëpër klasa.

Me futjen e nxënësve në qendra një e dalur tejet pozitive është rekomandimi i nxënësve nga drejtori/esha për largimin e telefonave dhe mjeteve të tjera elektronike e cila ka ndodhur në mbi 99% të qendrave të testimit të monitoruara nga KYC. Ky proces ka të bëjë me dispozitën e Udhëzuesit të Maturës Shtetërore 2022 i cili udhëzon që:

“Drejtori i shkollës me kryetarin e komisionit të dalin para hyrjes së shkollës 15 minuta para se nxënësit të futen mbrenda dhe t’ju rekomandojnë nxënësve që askush të mos futet mbrenda me telefona apo mjete tjera elektronike që janë të ndaluara sipas ligjit, ndryshe të gjitha ata që futen mbrenda me mjetet e lartcekura do të largohen dhe do e humbin të drejtën e rezultatit.”

Në krahasim me monitorimin e vitit 2020 ku ky rekomandim është dhënë në 88% të rasteve, këtë vit shohim ngritje të dukshme pozitive e cila vlen të theksohet.

## HYRJA E NXËNËSVE NË QENDËR



## NXËNËSVE JU ËSHTË REKOMANDUAR NGA DREJTORI/ESHA LARGIMI I TELEFONAVE




## KOHA E FILLIMIT TË TESTIMIT

Orari i caktuar për ditën e testimit, i cili paraqitet dhe në Udhëzuesin për Maturën Shtetërore - 2022 përcakton që nga ora 9:30 deri në orën 10:00 të ofrohen udhëzime dhe sqarime për kandidatët/et për testin dhe fletë-përgjigjet nga ana e administratorit/es të testimit. Përderisa, në ora 10:00 përcakton fillimin e testimit. Ndërkaq, sipas Udhëzuesit për Maturën Shtetërore,

*“Administruesit nuk duhet të lejojnë futjen e nxënësve në sallë pasi të fillojnë dhënien e udhëzimeve e po ashtu duhet të sigurohen që fillimi i testimit bëhet në kohën e caktuar (dhe pas sinjalit të dhënë nga Kryetari i Komisionit Qendror) dhe duhet të sigurohen që testimi përfundon në kohën e caktuar (150 minuta pas fillimit).”*

Mbi këtë bazë, në rreth 70% të qendrave të monitoruara testimi ka filluar në orën 10:00, kurse në qendrat e tjera kemi raste të fillimit qoftë disa minuta më herët ose me vonesë deri më 10:45.


## TESTIMI KA FILLUAR ME KOHË



# SHKELJET GJATË TESTIMIT

Për realizimin e qëllimit të mbarëvajtjes së procesit të Provimit të Maturës Shtetërore, sipas të gjitha kritereve dhe udhëzimeve të kredituara nga organet institucionale - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka nxjerrur një mori të udhëzuesve e udhëzimesh që rrjedhin si akte nën-ligjore me bazë Ligjin për Provimin e Maturës Shtetërore. Ku, ndër të tjera përcaktohen shprehimisht të gjitha detajet për mbarëvajtje të provimit, të drejtat dhe përgjegjësitë e secilës palë dhe institucion që përçon dhe vet angazhimin e të gjitha palëve për të u përcjellur të gjitha rregullat e sjelljes dhe realizimit të procesit të testimit. Ndjekur këtë esencë për të evituar çdo pa-rregullësi dhe shkelje, në Ligjin për Provimin e Maturës Shtetërore, neni 29, parashihen dispozitat ndëshkimore për secilën palë në rast se shkeljet vërtetohen dhe ndodhin. Prandaj, monitoruesit/et e KYC me vëmendje kanë përcjellur dhe identifikuar shkeljet me c'rast në 21.5% të qendrave të monitoruara janë raportuar shkelje të llojeve të ndryshme.

Pas pyetjes së hapur rreth asaj se a ka shkelje gjatë porcesit të testimit, monitoruesit kanë pasur për detyrë të japin detje më shumë rreth llojit të shkeljes, ku të njejtit raportuan: përdorimin e telefonave, përjashtimin e nxënësve, bisedimi mes nxënësve, fotografimi i testeve, zhurma e lartë, mbyllja e dyerve të klasave. Në të njejtën rrjedhë, në raportimet live shohim trende të shkeljeve në nivel të rajoneve ku në Rajonin e Prishtinës 29.7% e raportimeve kanë pasur të bëjnë me përdorimin e telefonave në klasë, në Rajonin e Pejës në 27.6% të raportimeve kemi problemin e zhurmës gjatë testimit, në Rajonin e Prizrenit 80% të raportimeve kanë adresuar çështjen e kopjimit, Rajoni i Gjakovës në 45.5% të raportimeve live kemi raportimin e përdorimit të telefonit sikurse në Rajonin e Mitrovicës me 30%. Në Rajonin e Ferizajit kemi ndarje të barabartë sa i përket shkeljeve të raportuara rreth: përdorimit të telefonit, zhurmës, kopjimit me nga 12.5% kurse mungesa e dokumenteve identifikuese u paraqit në 25% të raportimeve live në këtë rajon. Raportimet në komunën e Gjilanit në 50% të tyre kanë adresuar poashtu çështjen e përdorimit të telefonave.





# LARGIMI I NXËNËSVE APO ADMINISTRUESVE

Sipas nenit 3 paragrafit 2 pika 9 të UA për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit - dy anëtarët e Komisionit janë përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të provimit të maturës shtetërore dhe kanë për detyrë të marrin vendim për largimin e kandidatëve apo administruesve që nuk i përfillin rregullat e caktuara dhe ta zbatojnë atë përmes personave zyrtarë. Gjithashtu, përmes UA për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administruesit, neni 3, paragrafi 1.23 i jepë të drejtë administruesit/es “të largojë nga testi kandidatin në rast të mos-respektimit të rregullave dhe për këtë të njoftojë mbikëqyrësin”. Ndër të tjera, neni 4 i po të njëjtit akt nënligjor, paragrafi 8 përcakton që: “Mbikëqyrësi ka përgjegjësi të moj lejoj administruesit tu ndihmojnë kandidatëve dhe të reagojnë në situata të tilla. Në rast të mos-përfilljes së rregullave nga administruesit, në konsultim me kryetarin e Komisionit të qendrës së testimit e largon atë nga detyra”. Përveç këtij UA, përmes Udhëzuesit për Maturën Shtetërore është përcaktuar poashtu që “Kryetari i Komisionit u bënë me dije administruesve se raportet e mbikëqyrësit mund të raportojnë pa-rregullësitë dhe përveç ndalesës së pagesave do të ketë dhe masa të tjera nga MASHTI si p.sh publikimi i emrave për ata që kanë administruar keq procesin e testimit.”. Mirëpo duhet theksuar që Ligji për Provimin e Maturës Shtetërore – shprehimisht ka përcaktuar dispozitat ndëshkimore në rast të mos-respektimit të rregullave nga palët. Më saktësisht sipas ligjit:

1. Anëtarët e Komisionit në qendrat e testimit, administruesi, mbikëqyrësi dhe vëzhguesi i provimit të maturës shtetërore që shkel rregullat e administrimit të testit, ndëshkohet për kundërvajtje në shumë prej treqind euro (300) € deri në pesëqind euro (500) €.

3. Kandidatët të cilët gjatë provimit të maturës shtetërore shkelin rregullat e mirësjelljes, të përcaktuara me udhëzues përkatës për provim, ju anulohet testi i maturës dhe të njëjtët i nënshtrohen provimit në afatet vijuese.”

Në këtë rrjedhë në gati 40% të qendrave të monitoruara ka pasur largime të tilla për arsye si kopjimi, mungesa e dokumenteve identifikuese, mungesa e fletëparaqitjes, fotografimi i testeve, zhurma qoftë nga nxënësit qoftë nga administruesit e cila ka rezultuar në zëvendësimin e administruesve në fjalë. Nga kjo përqindje pjesa dërrmuese kishte të bënte me largimin e kandidatëve/eve kurse në dy raste largim të administruesve për shkak të raportimit të zhurmës në klasën të cilën administrojnë.

**QENDRA KU KA PASUR LARGIME NGA TESTIMI**

40%

# HYRJA E NXËNËSVE PAS FILLIMIT TË TESTIT DHE MBARIMI

Duke u bazuar në udhëzimet praktike të specifikuara në Udhëzuesin për Maturën Shtetërore,

Kryetari/ja i/e Komisionit duhet;

*“të sigurohet që dyert e qendrës së testimit janë mbyllur sipas orarit të paraparë (pra në momentin që kandidatët/et sistemohen) dhe pas kësaj kohe nuk do të lejohet hyrja e askujt në qendër të testimit”*

dhe udhëzon palët e tjera të ndërmarrin masat e duhura për të respektuar këtë përcaktim.


Nga monitorimi i afatit të parë të këtij procesi del se në 11.2% të qendrave të monitoruara ka pasur raste të hyrjes së nxënësve pas fillimit të testit të cilat kryesisht kanë qenë prezente në qendrat e papregaditura.

Udhëzuesi për Provimin e Maturës Shtetërore, ka bërë të qartë që testimi duhet të mbaroj në ora 12:30. Do të thotë pas dy orësh e tridhjetë minuta nga fillimi i tij në ora 10:00. Në rreth 60% të qendrave të testimit ky process është mbyllur në kohën e përcaktuar pra 12:30, ndërsa në pjesën tjetër kemi luhatje ku përfundimi i testimit është bërë disa minuta më vonë.

## NXËNËSIT KANË HYR PAS FILLIMIT TË TESTIMIT



## TESTIMI KA MBARUAR ME KOHË





**AFATI | DYTË**

# TË GJETURAT KRYESORE

- Nga 39 qendra të monitoruara, në 97.4% e tyre kanë qenë të përgatitura logjistikisht për testim;
- Nga 39 qendra të monitoruara, në 100% të rasteve drejtori/ja e shkollës ka njoftuar nxënësit që të largojnë telefonat;
- Nga 39 qendra të monitoruara, në 30% të qendrave të testimit kanë filluar testimin deri në 20 minuta vonesë;
- Nga 39 qendra të monitoruara, në 38.5% të qendrave të testimit kanë larguar të paktën një nxënës dhe administrues gjatë testimit;
- Nga 39 qendra të monitoruara, në 38.5% e qendrave të testimit kanë lejuar hyrjen e nxënësve pasi ka filluar testimi;
- Nga 39 qendra të monitoruara, në 18% e qendrave të testimit kanë përfunduar testimin deri në 10 minuta me vonesë.

# KOHA E ARRITJES NË QENDRËN E TESTIMIT DHE PËRGADITJA E TYRE


Koha e arritjes së monitoruesve në qendra të testimit nga monitoruesit e KYC është bërë nën të njejtat parime sikur se në afatin e parë ku monitoruesit janë paraqitur një deri në dy orë më herët në mënyrë që të jenë prezent që nga momenti fillestar i ardhjes së nxënësve në qendrat e testimit, kryesisht në mes të intervalit kohor 08:00-08:30. Kjo është bërë me qëllim të evidentimit të kohës se kur kandidatët/et futen në shkollë, evidentimin e pregaditjes së qendrës dhe ndonjë parregullësi eventuale. Niveli i pregaditjes së qendrave në këtë afat ka qenë pozitiv në shumicën e rasteve ku nga 39 qendrat e monitoruara në afatin e dytë 97.4% prej tyre ishin të pregaditura për mbajtjen e këtij procesi. Ndërsa, arsyet kryesore të evidentimit të qendrave si jo të pregaditura kanë qenë për: mos shënjimin e klasave të testimit në kohë dhe si duhet duke shkaktuar ngatërrimin e numrit të sallave e cila ka vështirësuar gjetjen e tyre prej administruesve dhe mungesa e numrit të shkollës në të njejtat salla.

## QENDRA ISHTE E PREGADITUR SIQ DUHET PËR TESTIM



## HYRJA E NXËNËSVE DHE MASAT PARAPRAKE

Konform Udhëzuesit për Maturën Shtetërore 2022 dhe Udhëzuesit dhe Rregullave për Kandidatët/et, futja e nxënësve u bë në orën 09:30 vetëm në 43.7% të qendrave të monitoruara, kurse në pjesën e mbetur ka pasur vonesa brenda intervalit prej 09:30 deri në orën 10:00. Kjo e dalur është në të njejtën rrjedhë me të dalurat e afatit të parë, e cila është pritshme nga KYC, mirëpo në të njejtën kohë e shton kredibilitetin e metodës së monitorimit.



## HYRJA E NXËNËSVE NË QENDËR

Sipas dispozitës së Udhëzuesit të Maturës Shtetërore 2022 i cili udhëzon që:

*“Drejtori i shkollës me kryetarin e komisionit të dalin para hyrjes së shkollës 15 minuta para se nxënësit të futen brenda dhe t’ju rekomandojnë nxënësve që askush të mos futet mbrenda me telefona apo mjete tjera elektronike që janë të ndaluara sipas ligjit, ndryshe të gjitha ata që futen mbrenda me mjetet e lartcekura do të largohen dhe do e humbin të drejtën e rezultatit.”;*


ky rekomandim është bërë në të gjitha qendrat e monitoruara nga KYC.

### **NXËNËSVE JU ËSHTË REKOMANDUAR NGA DREJTORI/ESHA LARGIMI I TELEFONAVE**



## **KOHA E FILLIMIT TË TESTIMIT**

Një e dalur e cila shënon rënie në krahasim me afatin e parë është koha e fillimit të testimit, ku nga qendrat e monitoruara vetëm 66.8% e tyre kanë filluar testimin në orën e përcaktuar me Udhëzuesin për Maturën Shtetërore – 2022, pra në orën 10:00. Pjesa tjetër qendrave të moniotruara kanë filluar testimin brenda intervalit prej 10:05 deri 10:20, ku në 12.8% të rasteve kemi fillimin e testimit në ora 10:05, në 5.1% të rasteve në ora 10:10, 5.1% në ora 10:15 dhe në 2.6% të rasteve në ora 10:20. Testimi ka filluar më herët sesa që është përcaktuar vetëm në një qendër të monitoruar në orën 9:45. Koha e fillimit të testimit natyralisht lidhet edhe me përgaditjen paraprake të qendrave e cila duhet të jetë në koordinim dhe të paraprijë çdo procedurë të mëtejshme të testimit. Natyralisht duhen të konsiderohen edhe faktorët e brendshëm të kandidatëve/eve të cilët i nënshtrohen testimit dhe impaktin që këto parregullësi dhe vonesa e kanë në rezultatet dhe gjendjen emocionale të tyre.



# SHKELJET GJATË TESTIMIT

Prezenca e shkeljeve gjatë afatit të dytë të Maturës Shtetërore shënon rënie në krahasim me afatin e parë për këtë vit, e cila paraqet një të dhënë pozitive e që megjithatë arsyetohet për shkak të numrit më të vogël të kandidatëve të cilët u nënshtrohen testimit, numrit më të vogël të qendrave dhe klasave të testimit e cila e bën gjendjen më të menagjueshme dhe vet sjellja e nxënësve të cilët kanë më pak tendenca ta rrezikojnë vlerësimin e tyre duke konsideruar se është afati i dytë. Monitoruesit tanë nga të gjitha qendrat të cilat janë monitoruar kanë raportuar shkelje në 10.3% të tyre. Në pyetjen e hapur se çfarë lloje të shkeljeve kanë hasur monitoruesit, ata kryesisht kanë adresuar problemin e kopjimit dhe përdorimit të telefonave. Ky problem është pasqyruar edhe në raportimet në kohë reale sidomos në Rajonin e Prishtinës ku nga 14 qendrat e monitoruara në këtë rajon në 35.7% të tyre është raportuar përdorimi i telefonit kurse në 21.4% të tyre është raportuar kopjimi në përgjithësi, ndërsa në rajonet e tjera nuk kemi pasur raportime direkte për këtë fenomen.

**QENDRA KU JANË RAPORTUAR SHKELJE**  10.3%

**RAJONI I PRISHTINËS**  35.7% (përdorimi i telefonave)

**RAJONI I PRISHTINËS**  21.4% (kopjimi)

## LARGIMI I NXËNËSVE APO ADMINISTRUESVE

Në 38.5% të qendrave të monitoruara ka pasur largime të kandidatëve/eve apo administruesve (pjesa dërrmuese ishin nxënës) e cila e dalur është në të njëjtën linjë nga monitorimi i afatit të parë. Nga rastet e raportuara këto largime të kandidatëve/eve kanë rezultuar si pasojë e: zhurmës, përdorimit të telefonit, problemeve me fletëparaqitje, mosparaqitja e testit dhe kopjimi. Ky proces është i paraparë me UA për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Administruesit, neni 3, paragrafi 1.23 i cili i jep të drejtë administruesit/es “të largojë nga testi kandidatin në rast të mos-respektimit të rregullave dhe për këtë të njoftojë mbikëqyrësin”. Përveq rasteve të largimit të kandidatëve, KYC-i i jep rëndësi administruesve të cilët nuk e kryejnë punën e tyre konform rregullave të parapara ligjrisht, prandaj rastet e largimit të administruesve poashtu evidentohen gjatë monitorimit. Nga rastet e raportuara për largimin e administruesve, shkaqet kryesore kanë qenë: mosadministrimi adekuat i klasës, mbikqyrja e mangët dhe zëvendësimi i tyre për arsye shëndetësore.

**QENDRA KU KA PASUR LARGIME NGA TESTIMI**  38.5%

# HYRJA E NXËNËSVE PAS FILLIMIT TË TESTIT DHE MBARIMI


Duke konsideruar të dalurat e afatit të parë ku hyrja e kandidatëve/eve pas fillimit të testimit është bërë në 11.2% të rasteve të monitoruara, kjo e dalur shënon një ngritje të theksuar gjatë monitorimit të afatit të dytë ku nga 39 qendrat e monitoruara në 38.5% të tyre ka pasur raste të hyrjes pas fillimit të testimit. Kjo paraqet shkelje të Udhëzuesit për Maturën Shtetërore i cili cek sigurimin e mbylljes së dyerve të qendrës së testimit sipas orarit të paraparë (pra në momentin që kandidatët/et sistemohen) dhe pas kësaj kohe nuk duhet të lejohet hyrja e askujt në qendër të testimit.

Mbarimi i testimit në 56.6% të qendrave të monitoruara ka shënuar në orën e përcaktuar, pra 12:30. Në 15.5% të rasteve përfundimi i testimit është bërë pas orës së përcaktuar në periudhën prej 12:30 deri 12:47, kurse në 23.2% të rasteve kjo është bërë më herët sesa ora e përcaktuar në intervalin kohor 12:00 deri 12:25. Kjo paraqet një dallim mjaft të madh mes intervalit kohor i cili është rrjedhojë e organizimit jo-adekuat të këtij procesi nga individët përgjegjës.

## NXËNËSIT KANË HYR PAS FILLIMIT TË TESTIMIT



## TESTIMI KA MBARUAR ME KOHË





# KONKLUZIONI

Monitorimi i Maturës Shtetërore paraqet një prej proceseve me të cilat KYC-i është familjarizuar qe disa vite dhe e kryen me vullnet të plotë duke konsideruar rëndësinë që e ka në sistemin arsimor. Ky testim është metoda e cila jep rezultate direkte të punës që realizohet në shkollat e mesme të larta të Kosovës përgjatë 3 viteve shkollore prandaj sigurimi i mbarëvajtjes dhe evidentimi i procesit është esencial për fushëveprimin e KYC në sistemin e edukimit.


Të dalurat e monitorimit të Maturës Shtetërore 2022 nuk janë befasi për KYC. Kjo pasi që të dalurat janë në përputhje me rezultatet e monitorimit nga vitet e kaluara të cilat i japin kredibilitet metodës së përdorur të monitorimit, mirëpo në anën tjetër paraqet një çështje e cila nuk ka shumë progres me vite me radhë sa i përket administrimit efektiv të testimit ndonëse në disa pika kemi përjashtime. Me anë të këtij procesi këtë vit KYC largoi nga testimi rreth 100 nxënës dhe 20 administrues të cilët kishin shkelur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre konform legjislacionit në fuqi.

Matura Shtetërore duke u konsideruar si pikë referuese e kualitetit të sistemit arsimor në shkollat e mesme të Kosovës lë hapësirë për disa pyetje dhe çështje diskutimi kur kemi të bëjmë me njëtrajtshmërinë e tij sa i përket lëndëve obligative me plan-programin e ndryshëm të shkollave, specifikisht drejtimeve të specializuara. Kjo çështje mund të paraqesë një pikë të rëndësishme të diskutimit të asaj se; A janë disa nxënës më në avantazh në krahasim me nxënës të tjerë gjatë testimit në bazë të plan-programit shkollor të cilit u janë nënshtruar? Çfarë disbalanci krijon ky fenomen në identifikimin apo vlerësimin e kapacitetit dhe njohurive të nxënësve? A duhet të mendohet një reformim më i thellë i strukturës së këtij testi?

Duke konsideruar të dalurat nga MASHTI për kalueshmërinë e nxënësve në Maturën Shtetërore dhe pozicionin e Kosovës në arenën ndërkombëtare sa i përket cilësisë së arsimit vlen të diskutohet poashtu çështja se rezultatet e testimeve të këtij lloji a pasqyrohen edhe në testimet në struktura më të gjera siq është vlerësimi PISA në të cilin Kosova ka një reputacion të vazhdueshëm të renditjes në vendet e fundit, gjersa vlerësimet e brendshme shënojnë përqindje pozitive të njohurive të përgjithshme të nxënësve e cila pasqyrohet në nivelin e kalueshmërisë. Kalueshmëria e Maturës në afatin e parë sipas MASHTI-it ishte 68.43% kurse në afatin e dytë ishte 60.2%, mirëpo çka do të thotë ky nivel i kalueshmërisë për të rinjtë e Kosovës; Krahasimi i njohurive të nxënësve të Kosovës me të rinjtë moshatar të vendeve në rajon? apo thjeshtë një faktor shtesë i cili ndikon në vazhdimin e studimeve në univerzitetet e vendit.

Qëllimi i një procesi të tillë duhet të jetë më largpamës dhe unifikues i cili duhet të reflektohet prej planprogrameve dhe procesit mësimor që nga klasa e 10-të e deri tek testimi dhe vlerësimi i njohurive të nxënësve të cilat si bazë duhet ta kenë arsimin cilësor.

Reformimi i shtyllave të tilla nuk mund të vijë sa hap e mbyll sytë mirëpo proceset e monitorimit dhe llogaridhënies mund ti shfaqin problemet thelbësore të një procesi të tillë siq është Matura Shtetërore edhe pse qëllimi i tij ka të bëjë me mbajtjen e rregullit dhe rendit të kësaj strukture ekzistuese. Insitucionet relevante duke qenë të informuara për aktivitetet e tilla nuk mund të mbahet në arsyetimin se procesi është vëshitrë i menagjueshëm. Struktura të tilla siq janë Grupi i Monitoruesve të Rinjë të KYC u jep mundësinë institucioneve të shohin rezultatet e një testimi të tillë me shkelje minimale përgjatë rrugës e pastaj të vendosin se a është ky proces në gjendjen aktuale adekuat për nevojat e të rinjëve të Kosovës dhe se a duhet ti kushtohet fokus më i thellë kualitetit të edukimit, vlerësimit dhe angazhimint të kuadrit të ri në institucione shkollore për ngritjen e rezultateve.



Gjithësesi ne besojmë se procesi i monitorimit është shumë me rëndësi për shtytjen e efektivitetit dhe llogaridhënies nga personat përgjegjës sidomos duke e pasur parasysh rëndësinë e Maturës Shtetërore si faktor në orientimin e nxënësve në studimet e mëtejshme.

Ne falenderojmë Ministrinë e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit për bashkëpunimin e vazhdueshëm ndër vite duke e fuqizuar rolin e KYC në procesin e monitorimit dhe evidentimit si mekanizmi i vetëm i pranuar dhe formalizuar funksional në këtë fushë çdo vit.

Një falenderim i veçantë poashtu i shkon Grupit të Monitoruesve të Rinjë të cilët janë shtylla kryesore e këtij procesi të cilëve asnjëherë nuk u mungon vullneti dhe gadishmëria për angazhim në çdo afat të mbajtjes së Maturës Shtetërore.

# REKOMANDIME

- Të bëhet në kohë përgatitja dhe publikimi i materialeve ndihmëse për provim të Maturës nga DVSM konform nenit 10 pika 1.5 i Ligjit për Provimin e Maturës Shtetërore;
- Të ju kushtohet vëmendje më e madhe përgaditjes së qendrave në aspektin logjistik me fokus evitim të problemeve me teste sidomos me lëndët zgjedhore;
- Të aplikohen dispozitat ndëshkimore për shkeljet nga administruesit konform paragrafit 1, të nenit 29 i Ligjit për Provimin e Maturës Shtetërore; Si dhe të bëhen publik emrat e administruesve që kanë bërë shkelje gjatë administrimit.
- Të vazhdohet ndërmarrja e masave të nevojshme, për kandidatët/et që nuk respektojnë rregullat e Provimit të Maturës, me theks për kandidatët/et që kopjojnë apo bashkëpunojnë;
- Të bëhet kontroll më i detajuar dhe rigoroz për eliminimin e paisjeve elektronike në qendra të testimit;
- Mbështetje për mekanizmat monitorues siq janë Grupi i Monitoruesve të Rinjë të KYC-it në aspektin e resurseve logjistike për monitorim;
- Kumbimin e afateve për ankesë tek kandidatët konform ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi;
- Identifikimin dhe trajtimin më rigoroz të konflikteve të interesit mes administruesve dhe kandidatëve;
- Formulimi i testeve specifike në bazë të programit të cilit kandidatët u janë nënshtruar gjatë 3 viteve në shkollat respektive;
- Obligimin e shkollave për organizim të orëve plotësuese për përgaditjen e kandidatëve nga mësimdhënësit e lëndëve obligative në shkollat përkatëse;

# MIRËNJOHJE

- Albulena Hasani
- Medina Fejzullau
- Durim Leci
- Uvejs Hyseni
- Visar Ismajli
- Viola Salihi
- Festina Shamolli
- Arbnore Mustafa
- Arjeta Krasniqi
- Eliza Osmani
- Rina Hasani
- Fjolla Gubetini
- Rinesa Hoti
- Fiona Oruqi
- Era Berisha
- Mensur Fetahu
- Vlora Dili
- Argjenda Sherifi
- Blerina Rrahmani
- Art Hasani
- Edona Dragusha
- Anduena Demaj
- Lorena Sherifi
- Gentiana Cakiqi
- Lumnije Sefedini
- Aulona Muçiçi
- Arneida Muçiçi
- Ermira Hakiqi
- Verone Pollomi
- Adelina Mehmeti
- Fitore Bytyqi
- Kaltrina Dvorani
- Hamit Elshani
- Ismajl Elshani
- Gonxhe Latifi
- Dete Preniqi
- Dijellza Preniqi
- Mirgena Preniqi
- Fisnik Eger
- Azra Qunglla
- Drita Dibrani
- Shkelqesa Trepca
- Vullnet Jakupi
- Angelika Berisha
- Elona Berisha
- Ema Hoxha
- Albina Biraj
- Albesa Biraj
- Etnik Besimi
- Diellza Bytyqi
- Qendrim Gashi
- Erza Muqaj
- Jasin Ramadani
- Redon Mehmeti
- Shkurte Rexhepaj
- Dardan Marovca
- Endrina Hajdini
- Lirim Hashani
- Artizane Krasniqi
- Fluture Latifaj
- Almedina Ismajli
- Murtez Zejnullahu
- Fitim Sadiku
- Fisnik Bekteshi
- Erion Sejdiu
- Lindita Sadrija
- Samir Selmani
- Riad Spahiu
- Bardhyl Raçi
- Shkurtesa Sadiku
- Behar Aliu
- Minire Hasani
- Ajshe Gavazi
- Rizah Shashivari
- Albion Burrniku
- Kastriot Sylejmani
- Donika Bytyci
- Eriona Fetahaj
- Ilirjada Fejzaj
- Ajshe Gavazi
- Albion Burrniku
- Kastriot Sylejmani
- Fleta Mujaj
- Diellza Asllani
- Blina Salihi
- Blendi Sheremeti
- Mirjeta Sylejmani
- Donika Bytyci
- Eriona Fetahaj
- Ilirjada Fejzaj
- Edon Morina
- Migjen Gashi
- Aferdita Bacaj
- Ronesa Hadergjonaj
- Alisa Gecaj
- Dardan Ukaj
- Arizona Lajqi
- Dafina Beqiraj
- Vlera Tarku
- Sehmedin Hadrovic
- Donika Ahmetaj
- Melisa Dobraj
- Genta Imami
- Mimoza Daija
- Artjona Rudi
- Ermira Mehmeti
- Ujvara Tahiri
- Dea Saraqini Shtanaj
- Erisa Lipoveci
- Diellza Berisha
- Alberite Bibaj
- Nafie Hoti
- Gentrira Uka
- Rezarta Nimani
- Refik Tupella
- Lirie Murati
- Donjeta Bojku
- Faton Osmani
- Djellza Berisha
- Driton Syla
- Argjend Alija
- Qendrim Tara
- Qendrim Hoti
- Qendrese Saraqi
- Eneida Xhakoli
- Rese Dermaku
- Anila Syla
- Hekuran Muja
- Ditjon Fetahu

# BIBLIOGRAFIA

Ligji nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore . 08/01/2016

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11341>

KYC . Raporti “Cilësia në Arsim” . 12/04/2022

<https://kyc-ks.org/2022/04/12/raporti-cilesia-ne-arsim/>

Raport Përmbledhës: Monitorimi i Provimit të Maturës Shtetërore 2020 .  
15/01/2021

<https://kyc-ks.org/2021/01/15/raporti-i-provimit-te-matures-shteterore-2020/>



